



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 60, Datë 08.04.2020

MBI

PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2020.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 201, datë 04.12.2017, i ndryshuar, të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 08.04.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin mars 2020,

Konstatoi se:

- FSHU sh.a me shkresën nr. 3185 Prot., datë 01.04.2020, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin mars 2020.
- FSHU sh.a deklaron se sasia e energjisë elektrike të blerë për muajin mars 2020 për klientët që furnizohen nga FMF është prokuruar vetëm në treg të parregulluar
- Nga procedurat të cilat janë kryer për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar për periudhën 01-31 Mars 2020, për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, janë marrë në konsideratë 5 procedurat të cilat janë realizuar gjatë muajit mars.
- Për përllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit janë marrë në konsideratë:
- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit:** bazuar në Vendimin nr. 198, datë 12.12.2019 “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020” është 0.75 lekë/kWh.

- **Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV**, bazuar në Vendimin nr. 199, datë 12.12.2019 të bordit të ERE “*Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit për vitin 2020*” është 1.5 lekë/kWh.
- Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë Lekë/Euro të ditëve kur shoqëria ka realizuar procedurat e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar.

Çmimi i FMF-së për muajin Mars 2020

Mars 2020		Njësia	Aplikimi FSHU sh.a. Çmimi	Propozimi i ERE Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	5.391	5.361
Pr	<u>Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)</u>	<u>Leke/kWh</u>	<u>0.16</u>	<u>0.16</u>
	Çmimi mesatar i blerjes ne periudhen relevante	Leke/kWh	5.55	5.52
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	9.59	9.56

- Për sa përcaktuar për çdo element të formulës llogaritëse rezulton që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2020 të jetë 9.56 Lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.56 lekë/kWh për muajin Mars 2020.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI